

Nr. 10691 Prot.

Tiranë, më 14/12 2021

Lënda: **Kthim Përgjigje tuajës Nr.925/5 Prot, datë 26.11.2021 lidhur me aplikimin e përditësuar për përcaktimin e tarifave të OSSH sha.**

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar
Enti Rregullator të Energjisë

Për Dijeni: **Z. Adrian ÇELA**
Administrator
OSHEE GROUP SH.A

I nderuar z. Ahmeti,

Në përgjigje të kërkesës suaj “Kërkesë për plotësim informacioni” me Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 protokolluar me tonen Nr.10691, date 26.11.2021, dhe te seances degjimore teknike te dates 03.12.2021, te njoftuar nga ana juaj me shkresen me Nr. 925/6 Prot, date 26.11.2021, protokolluar me tonen Nr.10692, date 26.11.2021, lutem si me poshte gjeni pergjigje lidhur me pyetjet tuaja si dhe dokumentacionin plotesues te kerkuar nga ana juaj.

1. Deklaroni parashikimin e kerkeses per energji elektrike per vitin 2022 si dhe rakordimin me Operatorin e Sistemit te Transmetimit dhe perdoruesit e Rrjetit te Shperndarjes. Bashkelidhur aplikimit paraqisni raportin e hartuar nga konsulentet lidhur me parashikimin e kerkeses per energji elektrike per vitin 2022 per cdo nivel tensioni. Paraqisni gjithashtu planin per reduktimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes per cdo nivel tensioni gjate periudhes 2020 -2025, mbi te cilin shoqeria ne aplikim deklarone se eshte bazuar ne parashikimin e kerkeses per energji elektrike.
 - a. Parashikimi i kerkeses per energji elektrike per vitin 2022 eshte kryer duke marre parasysh te dhenat nga perdoruesit e rrjetit te Shperndarjes:
 - Furnizuesi i tregut te rregulluar, FSHU,
 - Furnizuesit e Tregut te Lire, FTL dhe te tjere,
 - Parashikim mbi energjine e injektuar ne OST (si rezultat i energjise nga Prodhuesit me Perparesi te Energjise mbi kerkesen per konsum).

Me poshte jepet ky parashikim detajuar me komponentet sa me lart:

Komponentet e Bilancit Energjistik	Njesia	2022
Energji e Hyre ne Rrjetin e Shperndarjes	Mwh	7,581,968
Energji e konsumuar nga furnizuesit	Mwh	5,775,730
Energji shitur FSHU	Mwh	5,695,610
Energji shitur FTL	Mwh	34,800
Energy e kthyer ne rrjetin e OST	Mwh	320,000
Tregu i Lire	Mwh	45,320
Humbjet	Mwh	1,486,239
Humbjet (%)	%	19.60%

b. Per vitin 2022 eshte parashikuar nje rritje prej 1.5% kundrejt vitit 2021.

Ky parashikim krahasohet edhe me Masterplanin e Investimit dhe zhvillimit te rrjetit per sektorin e Shperndarjes (Investment and Network Development Plan for the Electricity Distribution Sector in Albania) nga konsulenca gjermane VPC GmbH, me financimin e Bankes Gjermane per Zhvillimin KfW , mbi parashikimin e ngarkeses per periudhen 2024 – 2034 i cili parashikon nje rritje nga mesatarisht nga 0.8% ne 1.8%. Ky raport nuk paraqet parashikim ne nivel tension por skenare (minimal, mesatar dhe maksimal) mbi energjine ne rrjetin e shperndarjes per segmente 5 vjecare. **Bashkelidhur** Masterplani. (CD)

FTL sha si kryesues i Grupit Balancues te OSHEE GROUP sha (OSSH, FSHU, FTL) ia ka percjelle OST sha kete parashikim te transformuar lidhur me pjesen qe prek rrjetin e saj. Bashkelidhur komunikimi shkresor me OST mbi kete ceshtje.

c. Lidhur me planin per reduktimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes per cdo nivel tensioni gjate periudhes 2020 – 2025, tabela e meposhtme paraqet kete permbledhje.

Description	Unit	2020 Actual	2021 Estimated	2022 Estimated	2023 Estimated	2024 Estimated	2025 Estimated
Total Losses by voltage levels							
HV (110/35/20/10/6kV)	%	1.53%	1.53%	1.52%	1.51%	1.50%	1.48%
35kV	%	4.13%	5.56%	5.52%	5.45%	5.40%	5.39%
20/10/6kV	%	4.55%	4.53%	4.49%	4.44%	4.42%	4.36%
0.4kV	%	16.53%	15.59%	14.80%	13.89%	13.43%	13.13%
Total Losses		21.48%	20.50%	19.60%	19.00%	18.50%	18.10%

2. Paraqisni historikun e sasise se energjise elektrike te levruar sipas perdoruesve per cdo nivel tensioni per periudhen kohore 2020 - 2021.

Tabelat e meposhteme paraqesin te detajuar sipas perdoruesve kerkesen totale te energjise ne nivel tensioni per periudhen 2020 – 2021, dhe parashikim 2022.

Kerkesa totale e energjise.

Niveli Tensionit (Mwh)	2020	2021	2022
35 Kv	103,040	101,574	102,336
20/10/6 Kv	569,949	1,024,050	1,060,414
0.4 kv	4,474,353	4,454,791	4,612,980
Total	5,147,342	5,580,415	5,775,730

Sasia e energjise për furnizuesin FSHU.

Niveli Tensionit (Mwh)	2020	2021	2022
20/10/6 Kv	569,949	1,024,050	-
0.4 kv	4,474,353	4,454,791	4,612,980
Total	5,044,302	5,478,841	4,612,980

Sasia e energjise për furnizuesit e tjerë në tregun e parregulluar te energjisë.

Niveli Tensionit (Mwh)	2020	2021	2022
35 Kv	103,041	101,574	102,336
20/10/6 Kv	-	-	1,060,414
Total	103,041	101,574	1,162,750

3. Duke marre ne konsiderate ndarjen ne tarife per kapacitet dhe energji ne perputhje me metodologjine dhe aplikimin e shoqerise OST sha behet e nevojshme paraqitja e te dhenave mbi bilancin e pikut koicidues te fluksit te ngarkeses apo te shumes totale te te gjithë ngarkesave jo-koiciduese per grupet e klienteve sipas nivelit te tensionit.

Vleresimi mbi pikun koincidues të flukseve ne nivel tensioni eshte ndertuar mbi keto te dhena:

- Per kerkesen totale jane perdorur te dhenat nga profili i Energjise se Hyre ne rrjetin e Shperndarjes. Eshte percaktuar per te dhenat historike nga viti 2020 dhe pjeserisht 2021 dita me kerkesen me te madhe per energji e cila eshte perdorur me tej per cdo nivel tensioni. Per vitet ne vazhdim, parashikimi eshte bere me rritjen e energjise.
- Kerkesa ne nivel tensioni 0.4 kV eshte vleresuar me deduksion duke marre parasysh nivelet e tjera te tensionit.
- Per kategorie e klienteve 0.4 kV Industry dhe Bakery jane perdorur te dhenat e disponueshme nga faturimi per intervalin Peak. Nderkohe per kategorie Household, eshte vleresuar me deduksion duke marre parasysh kategorie e permendur me lart.

Metodologjia e ndjekur eshte diskutuar dhe gjykuar e pranueshme nga koleget e RIO (Reform Implementation Office) prane MIE.

		2020	2021	2022	2023	2024
		Actual	Estimated	Estimated	Estimated	Estimated
Demand (at coincidental system peak)	MW	1,135	1,203	1,251	1,289	1,320
35kV	MW	4	8	8	8	9
20/10/6kV	MW	56	62	65	66	68
0.4kV	MW	1,074	1,133	1,179	1,214	1,243
Clients at 0.4kV-industry	MW	161	170	177	182	186
Commercial-bakery	MW	11	11	12	12	12
Household	MW	902	952	990	1,020	1,044

4. Paraqisni informacion/raporte per sasine e energjise elektrike te levruar per klientet te cilet furnizohen nga Furnizuesi i Mundesise se Fundit.

Tabelat e meposhtme paraqet ecurine mujore te sasise te energjise elektrike levruar per klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit per vitin 2020 dhe Janar-Tetor 2021.

MWh	2020	2021
Janar	3,180	2,350
Shkurt	3,086	1,572
Mars	2,648	1,555
Prill	1,573	1,417
Maj	2,062	1,631
Qershor	1,581	1,896
Korrik	1,947	1,850
Gusht	2,025	2,283
Shtator	1,825	1,749
Tetor	2,272	1,670
Nentor	1,787	
Dhjetor	2,076	
Viti 2020	26,063	17,972

5. Percillni dokumentacionin mbeshtetes mbi sasine e energjise se injektuar ne OST nga hidrocentralet e lidhura ne rrjetin e shperndarjes, krahasoni sasine e injektuar ne OST me ate te rikthyer ne rrjetin e shperndarjes dhe te paraqisni analizen lidhur me kete deklarim ne aplikim, duke percaktuar ne kete menyre edhe zonat problematike.

Kjo sasi energjie paraqitet si nje ze i vecante ne raportin e Bilancit Energjitik qe nga fundi vitit 2019 (metodologjia GROSS).

Bashkelidhur do te gjeni Bilancin Energjitik per vitin 2020 dhe vitin 2021 (Janar-Tetor).


Gjithashtu sasia e energjise së injektuar në rrjetin e OST eshte nje ze i vecante ne Akt Rakordimet mujore ndermjet OST dhe Furnizuesve pjese te OSHEE Group (FSHU dhe FTL) mbi Energjine e Transmetuar nga rrjeti OST-se.).


Bashkelidhur do te gjeni nje shembull te Akt Rakordimit per muajin Tetor 2021.

Me poshte nje paraqitje tabelare dhe grafike e ecurise se energjise së injektuar në rrjetin e OST per periudhe 2013 dhe 10M 2021, si edhe rritjen e saj nga viti ne vit dhe kundrejt vitit 2013.

Viti	Total Gross Energji	Tot Energji Net	PM - OST	BREE ne OSSH	Energji e inj. ne OST nga BREE ne OSSH
2013	7,199,316	7,145,061	6,743,241	401,820	54,256
2014	6,990,776	6,935,244	6,497,550	437,694	55,532
2015	6,592,914	6,494,866	6,007,778	487,088	98,049
2016	6,562,549	6,399,716	5,737,920	661,796	162,833
2017	6,636,562	6,498,515	6,026,763	471,752	138,048
2018	6,706,440	6,436,911	5,693,828	743,083	269,528
2019	6,805,811	6,576,432	5,907,870	668,561	229,380
2020	6,785,136	6,605,083	6,004,125	600,958	180,053
2021	6,173,675	5,836,307	5,060,546	775,761	337,369

Ecuria e energjise se injektuar ne OST nga BREE ne rrjetin e OSSH





Bashkelidhur do të gjeni gjithashtu dy analiza/vleresime lidhur me ndikimin negativ të energjisë së injektuar në rrjetin e OST nga Prodhuesit me Perparesi të Energjise në raste kur ky prodhim është me i madh se kërkesa për konsum në rrjetin e Shperndarjes.

Analizat/vleresimet janë kryer në periudha të ndryshme (diference tre vjecare) nga kendveshtrimi i penetrimit të Prodhuesit me Perparesi të Energjise në rrjetin e Shperndarjes (rrjedhimisht të sasisë së energjisë injektuar në rrjetin e OST), i pari në vitin 2018 dhe i dyti në vitin 2021.

Rezultatet e të dy analizave tregojnë një rritje prej rreth 1% të Humbjeve Totale në rrjetin e Shperndarjes nga ndikimi i rritjes së penetrimit të Prodhuesit me Perparesi të Energjise në rrjetin e Shperndarjes.

6. Paraqisni shpenzimet mbi koston e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve duke e ndare sipas burimit dhe cmimeve perkatese të realizuara për:
- cdo vit të periudhës 2015-2020,
 - periudhës Janar - Tetor 2021,
 - parashikimet për periudhën Nentor - Dhjetor 2021
 - parashikimet për vitin 2022.

Paraqitja e shpenzimeve për koston e energjisë së blerë për mbulimin e humbjeve për periudhën 2015 -2020 si dhe parashikimi për periudhën 2021-2022 paraqiten në tabelat më poshtë:

Për periudhën 2015 – 2020:

			2015	2016	2017	2018	2019	2020
Energji Gjithsej		Mwh	2,035,422	1,794,451	1,716,323	1,538,503	1,482,962	1,520,319
Sasi	Nga Ashta	Mwh	-	114,427	174,527	298,107	191,495	186,028
	Nga HEC private	Mwh	-	365,077	833,429	929,053	933,143	898,512
	Nga Burime te Rinov.	Mwh	-	-	-	-	22,196	32,265
	Nga Tregu I Lire	Mwh	2,035,422	1,314,947	708,367	311,342	336,128	403,515
Çmim	Nga Ashta	Lekë/Mwh	-	8.26	8.02	8.01	7.63	7.59
	Nga HEC private	Lekë/Mwh	-	7.45	7.45	8.57	8.46	7.88
	Nga Burime te Rinov.	Lekë/Mwh	-	-	-	-	12.27	12.41
	Nga Tregu I Lire	Lekë/Mwh	6.40	5.82	8.22	9.92	9.16	6.69
Lekë	Nga Ashta	000/Lekë	-	945,170	1,400,052	2,386,647	1,460,863	1,412,379
	Nga HEC private	000/Lekë	-	2,719,093	6,207,378	7,957,529	7,892,707	7,077,864
	Nga Burime te Rinov.	000/Lekë	-	-	-	-	272,403	400,447
	Nga Tregu I Lire	000/Lekë	13,035,606	7,655,028	5,824,331	3,088,230	3,080,050	2,700,870
Kosto Totale		000/Lekë	13,035,606	11,319,291	13,431,761	13,432,405	12,706,024	11,591,560

Për periudhën 2020 – 2021:

			2021 (10-mujor)	2021 (Nent-Dhjet)	2021 Total	2022	
Energji Gjithsej		Mwh	1,303,972	265,985	1,569,957	1,486,239	
Sasi	Nga Ashta	Mwh	-	250,186	43,944	294,130	231,264
	Nga HEC private	Mwh	-	826,117	198,911	1,025,029	1,022,113
	Nga Burime te Rinovueshme	Mëh	-	37,316	4,839	42,156	43,274
	Nga Tregu I Lire	Mwh	-	190,353	18,291	208,643	189,588
Çmim	Nga Ashta	Lekë/Mwh	-	7.73	7.80	7.74	8.57
	Nga HEC private	Lekë/Mwh	-	7.45	7.45	7.45	8.57
	Nga Burime te Rinovueshme	Lekë/Mwh	-	12.26	12.20	12.25	12.26
	Nga Tregu I Lire	Lekë/Mwh	-	18.98	29.34	19.89	15.95

Lekë	Nga Ashta	000/Lekë	1,933,374	342,974	2,276,348	1,980,822
	Nga HEC private	000/Lekë	6,152,921	1,481,493	7,634,414	8,754,600
	Nga Burime te Rinovueshme	000/Lekë	457,526	59,017	516,543	530,513
	Nga Tregu I Lire	000/Lekë	3,612,898	536,727	4,149,624	3,024,060
	Kosto Totale	000/Lekë	12,156,719	2,420,210	14,576,929	14,289,996

7. Paraqisni perlllogaritjet mbi koston e transmetimit te dokumentuar nepermjet faturave per blerjen e humbjeve per:

- cdo vit te periudhes 2015-2020,
- periudhes Janar -Tetor 2021,
- prishmerine per periudhen e mbetur te vitit.

Shpenzimet për transmetimin e energjisë 2015 – 2020 dhe parashikimi 2021 – 2022 paraqiten në tabelën më poshtë:

		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 (10-mujor)	2021 (Nent-Dhjet)	2021 Total	2022
Tarifa e transmetimit	Lekë/MWh	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75
Shpenzime transmetimi	000/Lekë	1,323,024	1,166,393	1,115,610	1,153,877	1,112,221	801,106	602,979	119,693	722,672	664,679

OST faturon FSHU për transmetimin e energjisë së OSHEE grup (FSHU dhe OSSH). Ndarja e shpenzimeve të transmetimit ndërmjet FSHU dhe OSSH bëhet në bazë të bilancit energjistik. Pasi zbrit vlerën e transmetimit të energjisë së shitur sipas bilancit FSHU ja faturon diferencën OSSH e cila përfaqëson shpenzimet e transmetimit për energjinë e humbur në rrjetin e shpërndarjes.

8. Paraqisni metoden e llogaritjes se humbjeve ne rrjetin e shperndarjes duke shpjeguar dhe analizuar levizjen e plote te energjise elektrike se injektuar ne OST nga hidrocentralet e lidhura ne rrjetin e shperndarjes,

Llogaritja e humbjeve ne rrjetin e Shpendarjes bazohet ne diferencen e shumes se komponenteve/flukseve te energjise te cilat hyjne ne kufirin operacional te rrjetit te Shperndarjes me shumen e atyre qe dalin. Tabela e meposhtme paraqet komponentet/flukset hyrese dhe dalese ne kufirin operacional te rrjetit te Shperndarjes dhe ilustron menyren e perlllogaritjes.

	Fluks Hyres	Fluks Dales
Energjia e injektuar nga OST ne rrjetin e OSSH	X	
Energji elektrike e injektuar ne OST nga PPE ne rrjetin e OSSH		X
Prodhimi I injektuar ne OSSH nga PPE ne rrjetin e OSSH	X	
Energji e Totale Shitur nga Furnizuesi FSHU Sh.a		X
Energji e Totale Shitur nga Furnizuesit ne Tregun e Lire (parregulluar)		X
Demi Ekonomik (aplikimi vendimit te ERE 232/2019)		X
Total Flukse	\sum Flukse Hyres	\sum Flukse Dales
Humbjet totale ne rrjetin e OSSH ne vlere absolute	\sum Flukse Hyres	\sum Flukse Dales
Humbjet totale ne rrjetin e OSSH ne vlere relative (% e \sum Flukse Hyres)	Humbje ne vlere absolute / \sum Flukse Hyres	

Bashkelidhur do te gjeni materialin e perdorur ne diskutimet me ju ne kuadrin e zbatimit te metodologjise GROSS te perlllogaritjes te Humbjeve ne rrjetin e Shperndarjes ne fund te vitit 2019. Sqarojme sipas kesaj metodologjie Humbjet ne vlere Absolute (ne MWh) jane te njejta me metodologjine NET. Kjo metodologji trajtohet edhe ne raportin e Keshillit e trupave Rregulatore Evropiane te Energjise mbi Humbjet (dokumenti C17-EQS-80-03 Report on Power Losses from the Council of European Energy Regulators (CEER), faqe 33) te cilin e gjeni bashkelidhur.

9. Paraqisni bashkelidhur aplikimit tuaj listat e llogarive te shoqerise ne zbatim te "Sistemit te njehsuar dhe te standartizuar te llogarive per te licensuarit ne sektorin e energjise elektrike per aktivitetet e transmetimit, shperndarjes dhe furnizuesit te sherbimit universal te energjise elektrike ", miratuar me Vendimin e Bordit te ERE nr. 244/2018.

Ju lutem gjeni bashkëngjitur këtij dokumenti një listë të llogarive sipas bilancit verifikues të shoqërisë në datën 31.12.2020.

Sikundër kemi theksuar në shkresën tonë Nr. 16156/1 Prot. Datë 11.9.2018 në përgjigje të shkresës suaj Nr. 556 datë 16.08.2018 “Marrje mendimi lidhur me miratimin e sistemit të njehsuar dhe standartet e llogarive”, lista e llogarive në OSSH është në përputhje të plotë me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe rregjistrimet kontabile dhe Pasqyrat Financiare auditohen çdo vit nga auditorë vendas dhe ndërkombëtarë të cilët e kanë gjetur Listën e Llogarive në përputhje me Standartet Ndërkombëtare. Lista aktuale e llogarive përmban informacion historik ndryshimi i të cilit do të sillte kosto dhe vështirësi në riklasifikimin e zërave dhe të krahasimit të rezultateve sipas treguesve historikë të audituar.

Bashkëngjitur shkresa Nr. 16156/1 Prot. Datë 11.9.2018.

10. Paraqisni dhe dokumentoni veprimet qe jane kryer per kalimin e detyrimeve te mbartura ne kuader te ndarjes ligjore te shoqerise meme OSHEE sh.a dhe llogaritjen e korigjimit te te ardhurave qe i perkasin vetem OSSH sh.a, te deklaruar nga shoqeria si humbje nga ushtrimi i aktivitetit te shperndarjes se energjise elektrike.

Bashkëngjitur dokumenti i auditorëve ligjorë lidhur me vlerësimin e ndarjes nëpërmjet transferimit të aktiviteteve të shoqërisë ku do të gjeni informacionin e detajuar.

11. Përcillni studimet e kryera dhe argumentat perkates per ndarjen e asetëve dhe humbjeve per cdo nivel tensioni, te shoqeruar me evidenca sipas pasqyrave financiare e te shoqeruar me listat e llogarive, per ndarjen e humbjeve per cdo nivel tensioni.

Informacion lidhur me ndarjen e asetëve dhe humbjet në nivel tensioni gjenden të detajuara në kapitullin 5 të dokumentit të Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes faqe 53 – 57.

12. Paraqisni raportin mbi investimet e realizuara dhe te futura ne operim te ndara per cdo nivel tensioni dhe sipas grupeve te asetëve per:

- a) cdo vit te periudhes 2015 - 2020,
- b) periudhen Janar - Tetor 2021
- c) parashikimet per periudhen Nentor - Dhjetor 2021

Ndarja ligjore e OSHEE GROUP sha u krye në fillim të vitit 2020 ndërsa ndarja funksionale përshi edhe ndarjen e asetëve përfundoi në fund të vitit 2020 bazuar në Planin e Veprimit për ndarjen funksionale të dërguar në ERE me shkresë gjatë vitit 2020. Në këtë kuptim ndarja e asetëve ndikoi në krijimin rishtazi të listës së asetëve të rregulluara në OSSH e cila do t'ju dërgohet me CD.

Gjendja e vlerës së asetëve sipas grupeve në OSSH në datën 31.12.2020 paraqitet në tabelën më poshtë:

000/Lekë

Llogaria e vlerës fillestare	Emertimi i llogarisë	Vlera fillestare 31.12.2020
208000	Te tjera AAGJ - JM	58,679
208100	Software	547,650
211000	Toka	1,064,968
211100	Permiresimi I Tokave	369,108
212000	Ndertesa dhe Konstruksione	4,346,008
213000	Makineri dhe Pajisje	48,137,033
215000	Mjete Transporti	381,454
218100	Pajisje Zyre	175,125
218200	Pajisje IT	1,514,322
232100	AAGJ - JM ne Proces	161,498
232200	AAGJ - M ne Proces	12,670,086
	Totali	69,425,932

Dhe ndarja e këtyre asetëve në nivel me vlerën neto të akumuluar paraqitet në tabelën më poshtë:

000/Lekë

	Vlera historike e aseteve	Amortizimi	Vlera Neto
TL	4,027,763,503	(773,953,973)	3,455,747,180
35kv	3,457,530,877	(1,009,492,209)	2,474,156,379
20/10/6kv	31,136,927,320	(8,194,174,671)	23,560,567,154
0.4kv	30,803,710,154	(11,521,889,742)	18,435,950,546
TOTAL	69,425,931,853	(21,499,510,595)	47,926,421,259

Investime në rrjetin e OSSH.

Në tabelën më poshtë paraqesim kontratat e lidhura në 2020 për t'u zbatuar në 9 mujorin e parë vitit 2021 si dhe kontrata të lidhura në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, për zbatime projektesh në fushat e sipërcituara, sipas Rajoneve përfituese të investimeve.

Duhet sqaruar se, fundviti i 2020, pra tremujori i fundit, pati rifillim të investimeve të reja të cilat në pjesën më të madhe të tyre rreth 90% e kontratave u përfunduan dhe hyne në operim në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Janar-Tetor 2021						
Rajoni / Viti	Vlera e punimeve të kontraktuara në vitin 2020 dhe që u mbyllën në 2021	Realizimi i punimeve në terren për vitin 2020 (Leke)	Realizimi i tyre për vitin 2020	Vlera e punimeve të kontraktuara në vitin 2021	Realizimi i punimeve në terren Janar – Tetor 2021 (Leke) për kontratat 2020+2021	Realizimi Janar – Tetor 2021
			(%)			(%)
Rajoni TIRANE	721,840,578		0%	2,016,370,123	1,611,542,107	59%
Rajoni ELBASAN	729,605,538	6,979,632	1%	926,783,652	1,298,129,875	78%
Rajoni BURREL	124,420,662		0%	664,578,562	372,163,275	47%
Rajoni SHKODER	540,955,747	140,650,114	26%	491,132,882	997,607,357	97%
Njesia KUKES	36,665,000	4,399,800	12%	277,535,336	236,950,264	75%
Rajoni BERAT	522,270,258	2,510,199	0%	343,733,863	645,603,082	75%
Rajoni DURRES	603,126,151	65,737,598	11%	2,696,636,027	2,325,921,287	70%
Rajoni KORCE	119,739,951		0%	634,368,750	300,616,708	40%

Rajoni Gjirokaster	107,402,166	1,801,300	2%	253,446,776	312,991,644	87%
Rajoni FIER	156,755,705		0%	1,858,068,613	856,635,412	43%
Rajoni VLORË	159,569,572	49,937,509	31%	417,914,684	321,509,437	56%
Total	3,822,351,328	272,016,152	7.1%	10,580,569,267	9,279,670,448	64%
Kontrate Mallra DTL	544,682,261			1,127,618,260	1,172,149,561	70%

Viti 2021 ka pasur realizim të rreth 75% të investimeve të kontraktuara në gjashtë mujorin e parë të 2021 të cilat kanë hyrë në operim, ku peshën më të lartë të tyre e zë kalimi i rrjeteve TM/TU nga 6kV dhe 10 kV në rrjetin 20/0.4 kV në përputhje me strategjinë e kompanisë për uljen e humbjeve.

Hyrja në operim e investimeve që kanë përfunduar nga Janari – Tetor 2021 si dhe parashikimi i hyrjes në operim të investimeve që kanë përfunduar ose pritet të përfundojnë Nentor – Dhjetor 2021.

Një pasqyrë më të qartë në vlera të investura me ndarjen sipas niveleve të tensioneve dhe kategoritë e aseteve të OSSH sha e kemi paraqitur më poshtë ku janë ndarë treguesit e realizimeve gjatë vitit 2021 dhe pritshmëritë deri në Nëntor – Dhjetor 2021, ndërkohë që në një kolonë të ndarë janë reflektuar dhe investimet në proces që pritet të hyjnë në operim me perfundimin e tyre në gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.

Investimet e realizuara dhe te futura ne operim gjate 2021	Investime 2020 – 2021 te hyra ne operim brenda Janar – Tetor 2021	Pritshmerite Nentor -Dhjetor 2021	Investime nga 2021 qe priten te mbyllen dhe hyjne ne operim ne 2022	Total
	ALL	ALL	ALL	ALL
Ndertim rikonstruksion N/Stacioni (110/35/20/10kV)	1,047,568,476		1,147,939,747	2,195,508,223
ndertim rikonstruksion linje TL (35kV)	189,579,115		377,949,000	567,528,115
Ndertim Rrjeti TM (20 kV)	509,616,798	144,415,497	311,010,025	965,042,320
Ndertim rrjeti TM/TU (20/0.4kV)	5,579,401,779	1,554,710,260	3,195,443,018	10,329,555,056
Ndertim rikonstruksion kabinash (20/10/6/ 0.4 kV)	69,820,302	50,271,407	-	120,091,709
Investime ne ABC (0.4kV)	3,274,052		163,337,595	166,611,647
Teknologji	921,940,953	-	-	921,940,953
Investim ne matje	198,010,000	-	-	198,010,000
Kosto Lokale BB (punetori	-	-	-	-
Zyra			255,967,248	255,967,248
TOTAL INVESTIME	8,519,211,475	1,749,397,164	5,451,646,633	15,720,255,271

13. Ne perputhje me percaktimet e pikes 4 te nenit 75 te Ligjit 43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike ", i ndryshuar, "Rregullores per procedurat e paraqitjes dhe miratimit te planit te investimeve nga operatoret e transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike", miratuar me vendimin e Bordit te ERE-s nr. 135, date 06.09.2017, duhet te paraqisni ne ERE planin e investimeve qe i korrespondon periudhes perkatese rregullatore, te shoqeruar me analiza dhe dokumentacionin mbeshletes si dhe perditesimin e planit 5-vjeçar te zhvillimit te rrjetit te shperndarjes,

Me shkresen Nr.9505 Prot, date 25.10.2021, kemi paraqitur Planin e Investimeve per vitin 2021 dhe perditesimin e Planit te Zhvillimit te rrjetit te shperndarjes per periudhen 5 vjecare (2018-2022) te shoqerise OSSH sha, ne te cilen jane paraqitur Tabela e Planit të Investimeve për vitin 2021, Tabela e realizimit faktik të 6 mujorit të parë të vitit 2021, Tabela e përditësimit të Planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5 vjecare 2018-2022 dhe Relacioni shpjegues per to.

Plani i 2022 i paraqitur eshte parashikuar 10.598 mld me investimet e domosdoshme, te cilat kerkojme te konsiderohen edhe ne kuadrin e aplikimit per tarifen e vitit 2022. Plani i Investimeve 2022 eshte i lidhur me planin e 2021, pasi eshte vazhdimesia e investimeve te iniciuara.

Ne kuadrin e situates se krijuar nga gjendja e jashtezakonshme e furnizimit me energji elektrike, VKM 584/2021, frenimi i investimeve per shoqerine, ku duhet te kryhen vetem investimet qe do te gjykohen te domosdoshme, VKM e dates 10.12.2021 per ndryshimin e nivelit te humbjeve do te parashikohen ne ndryshimet e nevojshme te planeve 2021-2022, 5 vjecarin 2018-2022, si dhe ne pergatitjen e planit te 5 vjecarit te ardhshem 2023-2027.

14. Ne aplikimin tuaj verehet se shoqeria ka konsideruar si vit testimi vitin 2020. Ne vijim duhet te paraqisni te gjitha te dhenat qe shoqeria disponon mbi realizimin faktik te cdo treguesi financiar, te ardhurat dhe tarifat e aplikuar te realizuara ne forme analitike per secilin grup shpenzimesh si dhe efektet e tyre per:

- a) realizimin e vitit 2020
- b) realizimin e periudhes Janar - Tetor 2021
- c) parashikimin per periudhen Nentor - Dhjetor 2021 dhe vitit 2022

Viti 2020 ishte viti i parë i funksionimit të shoqërisë në mënyrë të pavarur, megjithatë nuk gjendet në aplikim ndonjë vlerësim që e konsideron vitin 2020 si vit testimi në kuptimin e periudhës rregullatore sipas metodologjisë së tarifave.

Informacion lidhur me realizimin e vitit 2020 gjendet në dokumentin e pasqyrave financiare të dërguara më parë në ERE si dhe në analizën e treguesve kryesorë të realizuar dhe të krahasuar me ata të planifikuar në faqet 10 -11 të Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Realizimi i treguesve kryesorë të shoqërisë krahasuar me ata të planifikuar për periudhën Janar-Tetor 2021 gjendet në tabelën më poshtë:

000/Lekë	Pershkrimi	Janar-Teor 2021	Buxheti Janar- Tetor 2021	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shpërndarja	22,632,490	21,484,327	↑ 1,148,163	105%
	Te tjera	89,887	33,669	↑ 56,218	267%
	Gjithsej	22,722,377	21,517,996	↑ 1,204,381	106%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	12,156,719	8,892,814	↓ 3,263,906	137%
	Transmetim dhe disbalanca	832,190	594,850	↓ 237,340	140%
	Shpenzime Operative	9,386,238	8,962,512	↓ 423,726	105%
	Provizione	-	-		
	EBITDA	347,230	3,067,821	↓ (2,720,591)	11%
	Amortizimi	2,565,622	2,104,084	↓ 461,538	122%
	Shpenzime Financiare	27,750	(210,273)	↓ 238,023	-13%
	Tatim Fitimi	-	176,351	↑ (176,351)	0%
Gjithsej	24,968,520	20,520,338	↓ 4,448,181	122%	
REZULTATI I FINANCIAR		(2,246,142)	997,658	↓ (3,243,800)	-225%

Realizimi i pritshëm i treguesve kryesorë të shoqërisë krahasuar me ata të planifikuar për vitin 2021 gjendet në tabelën më poshtë:

000/Lekë	Pershkrimi	Realizimi i pritshëm 2021	Plani Financiar 2021	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shpërndarja	26,744,791	25,781,192	↑ 963,598	104%
	Te tjera	108,481	40,403	↑ 68,078	268%
	Gjithsej	26,853,272	25,821,596	↑ 1,031,676	104%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	14,576,929	10,671,376	↑ 3,905,553	137%
	Transmetim dhe disbalanca	1,204,897	713,820	↑ 491,077	169%
	Shpenzime Operative	12,234,570	10,755,014	↑ 1,479,556	114%
	EBITDA	(1,163,125)	3,681,385	↓ (4,844,510)	-32%
	Amortizimi	3,078,747	2,524,901	↓ 553,846	122%
	Shpenzime Financiare	11,404	9,295	↓ 2,109	123%
	Gjithsej	31,106,548	24,674,406	↑ 6,432,141	126%
REZULTATI I FINANCIAR		(4,253,276)	1,147,189	↓ (5,400,465)	-371%

15. Dokumentoni dhe paraqisni informacion mbi analizen e secilit ze dhe vlerat e komponenteve te te ardhurave te kerkuara per vitin 2022.

Analiza për zërat e të ardhurave është pjesë e Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në faqet 43 – 65.

16. Paraqisni te ardhurat e realizuara nga vendosja e demit ekonomik per vitet 2020 - 2021, te evidentuara per cdo nivel tensioni.

Të ardhurat nga Dëmi Ekonomik për vitin 2020 ishin 415,372 mijë Lekë, ndërsa ato të realizuara për periudhën Janar – Tetor 2021 ishin 270,464 mijë Lekë. Pagesat jane te nivelit te tensionit 0.4 kV.

17. Paraqisni te ardhurat e realizuara nga tarifa prej 200 ALL/muaj per klientet me konsum 0 kwh, te ardhurat nga Lidhjet e Reja dhe te ardhurat e energjise reaktive te ndara sipas niveleve te tensionit per periudhen 2015-2021 si dhe pritshmerine per vitin 2022.

Të ardhurat nga tarifat e realizuara për klientët me konsum “0 kwh” paraqiten në tabelën si më poshtë:

Te ardhura nga tarifa "0 kwh" 000/Lekë	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Jan- Tet. 2021	Parashik. 2022
	664,384	625,197	565,850	593,233	636,050	657,760	533,170	639,804

Të ardhurat nga tarifat e realizuara nga Lidhjet e Reja paraqiten në tabelën si më poshtë:

Të ardhura nga Lidhjet e Reja 000/Lekë	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Jan- Tet. 2021	Parashik. 2022
	645,104	540,865	649,137	652,914	642,384	532,075	557,381	532,075

Të ardhurat nga energjia reaktive paraqiten në tabelën si më poshtë:

Të ardhura nga energjia reaktive 000/Lekë	2015	2016	2017	2018	2019	2020 Nga FSHU	Jan- Tet. 2021 FSHU	Parashi. 2022 FSHU
	316,594	318,132	328,551	348,054	355,920	394,012	336,722	371,226

Bazuar ne parashikimin e te ardhurave nga energjia reaktive per vitin 2022, vetem nga FSHU, dhe duke qene se kjo sasi te ardhurash eshte perfshire ne perlllogaritjen e tarifes se shperndarjes, e gjejme te arsyeshme qe te percaktohet nje cmim mesatar i aplikueshem nga OSSH Sh.a per te gjithë perdoruesit Jofamiljare te rrejtit, te cilet nuk e kane cosØ me te madhe ose te barabarte me 0.9, sipas Vendimit të ERE Nr. 80, datë 14.11.2006 për “Përcaktimin e cmimeve të energjisë reaktive për subjektet Jofamiljare”

Ne menyre qe;

- Te mos rriten efektet financiare te perdoruesve te rrjetit, ne kuader te situates aktuale te tregut te energjise elektrike, ku cmimi i energjise aktive eshte i larte.
- Liberalizimit te tregut te energjise elektrike, i cili do te sjelle daljen e menjehershme ne Janar 2022 te te gjithë konsumatoreve te lidhur ne Tension te Mesem, te cilet jane gjithashtu edhe shkaktaret kryesore te energjise reaktive.
- OSSH Sh.a do te duhet te faturroje konsumin e energjise reaktive 15% te asaj aktive dhe te ardhurat e parashikuara jane te mjaftueshme per impaktin negativ qe shkakton kjo energji ne rrjetin e shperndarjes.
Sa me siper, do te propozonim, qe ky cmim te perlllogaritet sipas te ardhurave te parashikuara nga energjia reaktive dhe sasise totale te energjise reaktive te vlefshme per t'u faturuar pergjate vitit 2022;

PARASHIKIMI PER 2022	
1. ENERGJI E QARKULLUAR KVARH	193,359,151
2. TE ARDHURA NGA ENERGJIA REAKTIVE LEKE	371,226,000
3. CMIMI MESATAR LEKE/KVARH (3=2/1)	1.92

Ne konkluzion, per nje periudhe tranzitore, deri ne qartesimin e situates aktuale te furnizimit me energji elektrike, qe lidhet me arsyet e permendura, cmimi i energjise reaktive te jete 1.92 Leke/kvarh, per te gjithë perdoruesit e rrjetit, panvaresisht cmimit te energjise aktive qe ata furnizohen ne treg te rregulluar apo ne ate te parregulluar.

18. Paraqisni argumentat dhe shpjegimet e nevojshme mbi metoden dhe koeficientet e alokimit te komponenteve te te ardhurave te kerkuara per cdo nivel tensioni.

Informacion të detajuar lidhur me metodën e përdorur për llogaritjen e koeficientëve të shpërndarjes në nivel tensioni gjenden në kapitullin 5 të dokumentit të Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes faqe 53 – 57.

19. Paraqisni strukturen e plote organizative te shoqerise, numrin e punonjesve, pagen mesatare si dhe argumentoni kerkesen per rritje te fondit te pagave krahasuar me periudhat e meparshrne ushtrimore, duke bashkelidhur borderone e muajit tetor 2021 ku duhet te evidentohet niveli I pagave, trajtimeve financiare dhe cdo ze tjetër perberes te shpenzimeve te personelit te ndare per secilen nga kategorite e punonjesve per aktivitetin e shperndarjes

se energjise elektrike dhe aktivitete te tjera te shoqerise te cilat nuk jane te rregulluara nese ka.

Skema organizative shoqërisë është paraqitur në dokumentin e Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. si dhe me shkresën me Nr. 8754/2 Prot, date 20.10.2021. Shpenzimet e personelit për vitin 2022 në krahasim me ato të parashikuara për vitin 2021 janë parashikuar të rriten 3% në masën e rritjes së inflacionit sipas kontratës kolektive të punës të lidhur me sindikatat e punonjësve. Në kontratën e punës së punonjësve është parashikuar gjithashtu edhe pagesa e pagës së 13-të e cila nuk u pagua në vitin 2020 për shkak të rezultatit negativ të performancës së shoqërisë. Numri i punonjësve të OSSH në fund të muajit Shtator 2021 ishte 5,317.

Niveli i pagave sipas kategorive në OSSH është përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 574 datë 03.08.2016, bashkëngjitur këtij dokumenti.

20. Paraqisni informacion në menyre analitike për shërbimet koorporative për vitet 2020 - 2021 dhe parashikimin për 2022, shoqëruar me kontratat respektive/ fatura të likujduara gjatë kësaj periudhe për çdo shërbim të kryer nga OSHEE Group sh.a. Për të vlerësuar me drejt efektet e efciences së marrjes së shërbimeve koorporative krahasuar me periudhat e mëparshme ushtrimore lidhur me zërat, që përveç shërbimeve koorporative, evidentohen edhe në shpenzimet operative të shoqërisë si "Marredhenie me publikun"; "Teknologjia IT", "Shërbime Ligjore".

Theksojmë se kontratat e shërbimeve koorporative nuk pengon shoqëritë e grupit të kryejnë shpenzime të drejtpërdrejta për paisje dhe shërbime të të njëjtit grup shërbimesh. Kështu nëse një shërbim i specializuar për mirëmbajtje softëare në OSSH nuk mund të kryhet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit i OSHEE Grup ai kontraktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga OSSH dhe shpenzimet e këtij shërbimi janë pjesë e pasqyrës së performancës së kësaj shoqërie. Për shëmbull gjatë vitit 2021 OSSH ka kontraktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbim mirëmbajtje për njërin nga softëare me një vlerë mujore prej rreth 2,352 mijë lekë.

Më poshtë një analizë lidhur me të ardhurat nga shërbimet koorporative **për vitin 2020** në OSHEE (shoqëria mëmë) si dhe ndarja e këtyre shërbimeve për shoqëritë e OSHEE Grup përfshirë OSSH

Të Ardhura nga Shërbimet Koorporative

Të ardhurat nga shërbimet sipas kontratave të lidhura me shoqëritë e grupit OSHEE u realizuan bazuar në kontratat e shërbimeve. Bazuar në këto kontrata llogaritja e të ardhurave për çdo nivel shërbimi bazohet në mbulimin e shpenzimeve direkte për shërbimet e kryera, koston e kapitalit dhe një fitim prej 5% i cili supozohet të mbulojë nevojat për investime të mundshme për shoqërinë që ofron shërbimet si dhe për të krijuar rezerva për shpenzime të panjohura në çmim.

Të ardhurat ishin më të mëdha se ato të parashikuara në programin financiar të shoqërisë për arsye se:

- Shpenzimet financiare të cilat nuk ishin planifikuar u përfshinë në përlogaritjen e çmimit. Ndryshimi i metodologjisë së përlogaritjes në përfshirje të shpenzimeve financiare ishte rrjedhojë e faktit se këto shpenzime erdhën kryesisht si kosto e kredive të marra për nevoja të shoqërisë mëmë (OSHEE) për investime dhe mungesës së likuiditetit gjatë ushtrimit të aktivitetit në vitet e mëparshme për blerje energjie në tregun e lirë në kushte të thatësisë. Meqënëse këto aktivitete i takojnë periudhave kur shoqëritë e Grupit (OSSH dhe FSHU) nuk ishin krijuar ato mbetën si detyrim ligjor i OSHEE e cila trashëgoi një pjesë të madhe të këtyre detyrimeve.
- Përfshirje e shpenzimeve për provigjone të cilat nuk u planifikuan, por u llogaritën si pasojë e parashikimeve për shpenzime përmbarimore nga çështje ligjore të cilat janë të lidhura me aktivitetin e viteve të mëparshme që lidhen me veprimtari të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike dhe që nuk janë më pjesë e objektit të veprimtarisë së OSHEE. Për arsye se kontratat e lidhura në periudhat e kaluara janë në përgjegjësi të OSHEE këto shpenzime të paplanifikuara u përfshinë në kostot e kontratave të shërbimit të shoqërive.

Llogaritja e të ardhurave të shërbimeve paraqitet në tabelën më poshtë:

LLOGARITJA E TË ARDHURAVE TË SHËRBIMEVE NGA SHOQËRITË E GRUPIT

(000/Lekë)

Nr.	PËRSHKRIMI	TOTAL	OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRBIME TË MEDIAS	58,448	27,768	30,679	-
2	SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	80,568	69,348	10,848	372
3	SHËRBIME TË BURIMEVE NJERËZORE	86,528	74,478	11,651	399
4	SHËRBIME LIGJORE	319,573	78,482	236,152	4,938
5	SHËRBIMET MBËSHTETËSE	505,685	502,482	2,177	1,026
6	SHËRBIMET IT	769,278	398,279	365,047	5,952
7	SHËRBIMET EKONOMIKE	158,937	64,419	79,347	15,171
	TOTAL	1,979,017	1,215,256	735,903	27,858

Shpërndarja e kostos së shërbimeve për shoqëritë e grupit bazuar në metodologjinë (pjesë e kontratës së shërbimit) u krye bazuar në koeficientët e përlogaritur sipas tabelës më poshtë:

Nr	SHËRBIMI	KOEFIÇIENTËT E SHPËRNDARJES	OSSH	FSHU	FTL	Koeficienti		
						OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRB. TË MEDIAS	Përlogaritje direkte				47.51%	52.49%	0.00%
2	SHËRB. ZHVILL. BIZN.	Nr. i punonjesve	5,408	846	29	86.07%	13.46%	0.46%
3	SHËRB. BURIM. NJER.	Nr. i punonjesve	5,408	846	29	86.07%	13.46%	0.46%
4	SHËRBIME LIGJORE	Çështje ligjore	148	446	9	24.56%	73.90%	1.55%

5	SHËRB.MBËSHTETËSE	Vlera e asetëve	48,395,736	209,673	98,792	99.37%	0.43%	0.20%
6	SHËRBIMET IT	Nr. i përdoruesve	803	736	12	51.77%	47.45%	0.77%
7	SHËRB. EKONOMIKE	Nr I transaksioneve	19,125	23,557	4,504	40.53%	49.92%	9.55%

Përshkrimi i detajuar i koeficientëve të përdorur paraqitet në tabelën më poshtë:

Përshkrimi i Koeficientëve

Shërbime të Medias	– bazuar mbi përllogaritjet për OSSH dhe FSHU
Shërbime të Zhvillimit të Biznesit	– bazuar në peshën specifike të numrit të punonjësve për çdo shoqëri përfituese të shërbimit OSSH, FSHU dhe FTL) në raport me totalin e numrit të punonjësve që kanë këto shoqëri.
Shërbime të Burimeve Njerëzore	– bazuar në peshën specifike të numrit të punonjësve për çdo shoqëri përfituese të shërbimit OSSH, FSHU dhe FTL) në raport me totalin e numrit të punonjësve që kanë këto shoqëri.
Shërbime ligjore	– bazuar në peshën specifike të çështjeve ligjore për çdo shoqëri.
Shërbime Mbështetëse	– bazuar në peshën specifike të numrit të përdoruesve për çdo shoqëri përfituese të shërbimit OSSH, FSHU dhe FTL.
Shërbime Teknologji	– bazuar në peshën specifike të vlerës së aktiveve afatgjata neto për çdo shoqëri përfituese të shërbimit OSSH, FSHU dhe FTL.
Informacioni	
Shërbime Ekonomike	– bazuar në numrin e veprimeve në SAP për çdo shoqëri OSSH, FSHU dhe FTL.

Shpenzimet e drejtëpërdrejta të OSSH për vitin 2020 si më poshtë:

“Shpenzimet IT”	ishin	11,760 mijë Lekë
“Marrëdhënie me Publikun”		2,994 mijë Lekë
“Shpenzimet Ligjore”		31 mijë Lekë.

Parashikimet për vitin 2021 dhe 2022 janë detajuar në dokumentin e Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes faqe 43-45

Bashkëngjitur do të gjeni “Marrëveshjen për ofrimin e Shërbimeve” ndërmjet OSHEE (shoqëria mëmë) dhe OSSH si dhe faturimi i shërbimit për vitin 2020.

21. Paraqisni ne menyre analitike shpenzimet e mirembajtjes per periudhen 2020-2021 te ndara ne shpenzimet mirembajtje te cilat nuk rrisin jetegjatesine e asetëve, duke perfshire kostot deri ne 1,000,000 leke.

Informacioni i detajuar lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2020 gjendet në faqen 26 – 27 të Aplikimit për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe në dokumentin “Shpenzimet për Mirëmbajtjen” bashkëngjitur kësaj shkrese.

22. Identifikoni dhe paraqisni kostot e mirembajtjes se rrjetit te shperndarjes, per te percaktuar nje tarife kosto-reflektuese per mirembajtjen e perdoruesve te rrjetit pa konsum.

Rishikimi i kostos për mirëmbajtje për përdoruesit e rrjetit pa konsum nuk ishte pjesë e përlllogaritjeve të paraqitura dhe kërkon një studim të veçantë dhe kohën e nevojshme për kryerjen e tij.

OSSH do të kryejë një studim lidhur me kostot e kësaj kategorie klientësh dhe do të propozojë ndryshim të kësaj tarife.

23. Plotesoni informacionin duke paraqitur listen e bazes se rregulluar te asetete me kostot historike pa marre ne konsiderate rivleresimin e tyre

Lista e bazës së rregulluar të asetëve është një dokument i madh dhe do tju dërgohet me CD

24. Paraqisni informacionin e detajuar mbi amortizimin e akumuluar te bazes se asetete te rregulluara per cdo vit te periudhes 2015-2021 si dhe parashikimin per vitin 2022. Jepni argumentat dhe sqarimet tuaja mbi kriteret e perdorura per percaktimin e jetes operuese per te gjitha asetet qe perfshihen ne bazen e rregulluar te aseteteve pergjate vitit te fundit te periudhes koherente si dhe vleresimet per periudhen e ardhshme rregullatore

Baza e asetëve të rregulluara në OSSH u krijua rishtazi nga ndarja e asetëve të OSHEE Grup gjatë vitit 2020.

Më poshtë tabela e vlerës së asetëve dhe amortizimit të akumuluar:

Llogaria e vleres fillestare	Emertimi I llogarise	Vlera fillestare date 31.12.2019	Amortizimi I akumuluar 31.12.2019	Vlera e mbetur 31.12.2019	Shtesa 2020	Amortizimi I vitit 2020	Vlera fillestare 31.12.2020	Amortizimi I akumuluar 31.12.2020	Vlera e mbetur 31.12.2020
208000	Te tjera AAGJ - JM	58,679	(52,641)	6,038	-	(1,218)	58,679	(53,859)	4,820
208100	Softëare	497,730	(218,758)	278,972	49,920	(83,141)	547,650	(301,900)	245,750
